



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 50

Prishtinë, më 7.2.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Etem Arifi.

Munguan : Daut Haradinaj, Rasim Demiri.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtar nga MMPH dhe ministri, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE, ICO, Ambasada Amerikane), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 3.02.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3.2.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 3.2.2012.

3. Shqyrtimi i projektligjit për Agjencinë e rrezatimeve bashkërisht me Komisionin për Buxhet

Nait Hasani falënderoi për pjesëmarrjen e Komisionit për Buxhet lidhur me këtë projektligj dhe fillimisht sqaroi qëndrimin e këtij komisioni i cili vërejtjet e fundit ka hartuar me stafin dhe sugjerimet nga zyrtarët e Ambasadës Amerikane të cilët kanë propozuar që ky Agjenci duhet të ketë vendin pranë zyrës së kryeministrit. **Safete Hadërgjonaj** tha se komisioni për buxhet ka miratuar buxhetin e sivjetshëm duke pasur parasysh që ky agjenci të jetë e pavarur në kuadër të MMPH, gjithashtu është miratuar buxheti për puntorë përkatës në këtë agjenci, ndaj është konstatuar se nuk ka rëndësi ku do të ketë vendin agjencia (në MMPH apo pranë Kryeministrit) por do të jetë me rëndësi të caktohen qartë kompetencat, çka nuk është bërë mirë si duhet me këtë projektligj. Amendamentet e sugjeruara nga komisioni funksional, do të përmirësohen nga komisioni për buxhet dhe do të dërgohen stafit të komisionit. Ajo sugjeroi konkretisht çka do të ishte e udhës të ndryshohet, ndaj **Nait Hasani** falënderoi dhe theksoi se ky komision mirëpret këto përmirësime të cilat pastaj ky komision do të përcjellë sërish tek komisionet e përhershme.

Liburn Aliu përsëriti kërkesën e tij dhe arsyetoi pse duhet të jetë kjo agjenci pranë MMPH, duke pasur parasysh që një agjenci e tillë së pari duhet të përforcohet pastaj të vazhdoi si e pavarur. Shumë shtete, vazhdoi, janë më të zhvilluar se Kosova ku ka edhe reaktor bërthamor, megjithatë këtë agjenci e kanë pranë ministrit dmth pse te ne duhet të jetë e pavarur. Te ne ende nuk ka ekspert përkatës dhe duhet ende të zhvillohet etj. **Safete Hadërgjonaj** rikujtoi komisionin se përpara në legjislacionin e kaluar është folur në këtë mënyrë si Liburn Aliu por nuk ka funksionuar si duhet, ndaj edhe një herë përsëriti se nuk ka rëndësi agjencia ku do ta ketë vendin nëse përcaktohen si duhet detyrat e sajë, gjithashtu është me rëndësi që mos të jetë në kuadër të Kuvendit të Kosovës. **Muhamet Mustafa** kërkoi një seriozitet të lartë me rastin e caktimit të vendit të Agjencisë, ngase vendi i agjencisë duhet të jetë pranë MMPH për shkak të infrastrukturës së krijuar aty, poçes del jashtë ministrit është droja se do të ndodhin konfrontime financiare me agjencitë tjera me rastin e krijimit të “shtëpisë së re”.

Ferki Fejza (kryeshefi aktual i agjencisë së themeluar më 2011) sqaroi ecurinë e themelimit të agjencisë si theksoi ai pa asnjë cent, ndaj është dashur të drejtohen ministrit nga i cili nuk ka pasur përgjigje, është kërkuar sqarim nga Komisioni për Buxhet nga i cili komision ka marr përgjigje konkrete por jo edhe mjaftueshme, ngase sipas sqarimeve të komisionit tani 6 puntorë do të paguhen por pa llogarit edhe kryeshefin pa asnjë cent për mallra e shërbime. Në vazhdim u fokusua në diskutimin e Liburn Aliut dhe arsyetoi të kundërtën e konstatimeve nga ai, ngase si tha ai, ky agjenci nuk do të lëshoi vetëm licenca (me të cilat do të mirë vetëm një resor i tij) por trajtohet si agjenci kombëtare, për këtë arsye edhe duhet të jetë e pavarur pranë kryeministrit. Arsyet për pavarësinë e kësaj agjencie janë të shumta për shkak të fushës së gjerë të veprimtarisë, në shumë raste Kosova do të jetë e detyruar të menaxhoi raste radiologjike, nuk do të mund të jap llogari ky agjenci MMPH-së për rastet shëndetësore etj.

Latif Gashi sugjeroi parafolësin të drejtohet komisionit për buxhet me këto sqarime që u dëgjuan në këtë mbledhje.

Nait Hasani kërkoi sqarimin e përbashkët pse duhet të jetë agjencia aty apo aty, ndërsa **Ferki Fejza** shkurt u përgjigj se në rast të katastrofave të ndryshme rajonale, Kosova si duhet të veproi, dmth duhet me pas një ligj adekuat të pavarur për këtë fushë me agjenci të pavarur.

Sali Asllanaj u pajtua se kemi të bëjmë me çështje ndërkombëtare ngase duhet të kemi këshilla profesionale për çështjet si janë të natyrës së tillë, ai sugjeroi që agjencia mund të filloi pranë MMPH por gradualisht të transferohet pranë kryeministrit si agjenci e pavarur. **Liburn Aliu** nuk i mohoj ca fakte që u dëgjuan, mirëpo prapë mbeti pranë asaj se kjo agjenci duhet gradualisht të bëhet e pavarur, për shkak se fillimisht duhet të përforcohet, duhet të hartohen planet, të shkollohet stafi adekuat etj. Ai mori shembull Agjencinë për Veterinari i cili tani duhet ti kthehet ministrit. **Kryeshefi** reagoi dhe tha se të gjitha ato i ka Kosova, por duhet fillimisht të lejoj ligji themelimin, ngase për mospërgjegjësi përgjigjet dhe shkarkohet kryeshefi i agjencisë.

Muhamet Mustafa përsëriti kërkesën se duhet bërë gjërat me kujdese e jo në mënyrë gallopanante, të kemi kujdese sidomos kur është në pyetje administrata. **Latif Gashi** pyeti a ekziston ndonjë komision që i llogaritë gjërat dhe a ekziston mundësia për një kalkulim më të favorshëm-më të vogël me shpenzime, kryeshefi tha se ekziston dhe të gjitha janë llogaritë, mirëpo komisioni përkatës për buxhet si duket nuk është i njoftuar. **Albana Fetoshi** u pajtua për një agjenci që do të përforcohet dhe fillimisht do të instalohet në MMPH, mirëpo z. Gashi tha se nuk mund të jetë ky komision (për buxhet) më i aftë se ata që rekomandojnë themelimin e agjencisë. **Afërdita Berisha** pyeti për financimin e përmendur nga kryeshefi për 3 milion, mirëpo sqarimi ishte se ato janë parashikime afatmesme. **Safete Hadërgjonaj** njoftoi se MMPH nuk ka kërkuar asnjë centë për këtë agjenci dhe përsëriti kërkesat të cilat do të ishte mirë të miratohen nga komisioni funksional : rreth nenit 4 paragrafi 1, nenit 6 paragrafi 1, neni 11 pika 2, nenit 13 dhe nenit 19. Ajo gjithashtu sugjeroi nëse miraton komisioni që ky agjenci të kalojë pranë zyrës së kryeministrit, duhet të çeket se stafi ekzistues bartet në zyrën e kryeministrit. **Salih Morina** kishte kërkesën për komisionin për buxhet, që tjera herë kur ministria përkatëse rekomandon implikime financiare për një projekt, ky komision mos të miratoi atë projekt dhe të sugjeroi kthimin tek sponzorizuesi. **Safete Hadërgjonaj** tha se kjo është kompetencë e komisionit funksional, ngase komisioni për buxhet mundohet të reduktoj koston buxhetore si p.sh. poqes nuk do të mbahej ky takim i sotshëm, komisioni për buxhet është dashur të rekomandoi kthimin e projektligjit. **Muhamet Mustafa** rikujtoi të pranishmit se duhet të kanë kujdese ngase IPA p.sh. ose donatorët tjerë japin të holla vetëm për një vit, jo më tepër. **Nait Hasani** falënderoi dhe caktoi për mbledhjen e radhës definimin e amendamenteve të harmonizuara në këtë mbledhje, të cilat do të përcjellën komisioneve të përhershme.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Prizrenin

Kryetari Nait Hasani përshëndeti ministrin **Dardan Gashi** dhe fillimisht njoftoi për amendamentin e tij në cilësinë e deputetit lidhur me Nenin 16, pasi që në mbledhjen e kaluar komisioni votoi barabartë 3 me 3. **Afërdita Berisha** propozoi që në këtë nen të fshihet fjala “serbe” tek fjala Kisha ortodokse. **Sevdije Lama** sugjeroi që komisioni edhe një herë të votoi për këtë nen. **Kryetari** tha se procedura e rregullt megjithatë kërkon që mos të kemi kthim mbrapa por tani komisioni të deklarojë a mbështet amendamentet e kryetarit në cilësinë e deputetit, ndërsa në fund komisioni do të shikoj këtë mundësi të propozuar nga Sevdije Lama, të shkohet prapë me rivotimin e nenit 16 apo të shkohet me përkrahje apo pa përkrahje të amendamenteve të kryetarit në cilësinë e deputetit.

Komisioni vendosi si vijon :

PROPOZIM AMENDAMENTI 1

nga Deputetit Nait Hasani (e përkrahur nga Komisioni me vota 5 me 1)

Neni 16, nënparagrafi 1.1 riformulohet : “**gjashtë (6) anëtarë të trashëgimisë kulturore, arkeologjisë, arkitekturës nga shoqëria civile në Prizren, që kanë përvojë në ruajtjen, zhvillimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore ;**”

Në Nenin 16 fshihen nënparagrafët me pikat si vijon :

1.2. tre (3) anëtarë nga shoqëria civile sipas nënparagrafit 1.1. të këtij neni, do të përzgjidhen:

1.2.1. një (1) anëtar përzgjidhet nga Bashkësia Islame;

1.2.2. një (1) anëtar përzgjidhet nga Kisha Ortodokse Serbe dhe

1.2.3. një (1) anëtar përzgjidhet nga Kisha Katolike;

1.3. së paku dy (2) prej anëtarëve nga shoqëria civile do të jenë ekspertë të njohur në fushën e trashëgimisë kulturore, me kualifikim apo përvojë profesionale në fushë të tillë. Preferencë do të kenë kandidatët që i përmbushin të dy kriteret;

Fshihet paragrafi 6 i Nenit 16 :

6. Asambleja Komunale emëron anëtarët e Komitetit të përzgjedhur nga Kisha Katolike, Bashkësia Islame dhe nga Kisha Ortodokse Serbe për këtë mandat.

PROPOZIM AMENDAMENTI 2
nga Deputeti Nait Hasani (pa përkrahjen e Komisionit)

Në shtojcën II tek Objektet e Kishës Ortodokse Serbe fshihet pika 3 si vijon : Shkolla Ortodokse për Priftërinj e Shën Kirilit dhe Metodit (Shkolla e mesme ortodokse).

Amendamenti 8 dhe Amendamenti 9 nga Deputeti Hydajet Hyseni nuk përkrahet nga Komisioni.

Neni 16 paragrafi 10, Komisioni në mbledhjen e radhës duhet të sqarohet a mbetet fjalia në fund **“konform UA të MAPL nr.2008/10”**, për shkak të zëvendësimit të fjalës **“Komitet”** me **“Këshill”**.

Amendament (i radhës)

Neni 18, paragrafi 2, në rreshtin e dytë, pas fjalës **“Prizrenit”** shtohet **“sipas legjislacionit për trashëgiminë kulturore”**.

Komisioni mbështeti Amendamentin 3 nga Qeveria.

Komisioni mbështeti Amendamentin 4 nga Qeveria.

Neni 20, duhet të riformulohet bashkërisht me MMPH dhe Gjejlane Hoxhën.

Amendament (i radhës)

Neni 24, shtohet paragrafi si vijon :

3. Komuna aplikon lehtësira fiskale për personat fizik dhe juridik brenda zonës së Qendrës Historike të Prizrenit, konform nenit 5 të Ligjit për Trashëgimin Kulturore.

Nait Hasani falënderoi për bashkëpunim dhe sugjeroi vazhdimin e shqyrtimit të projektligjit në një mbledhje të radhës ku do të shqyrtohen përfundimisht amendamentet, pasi të kryhen obligimet e marra gjatë mbledhjes së sotme.

VËREJTJE NGA STAFI : Komisioni duhet të shqyrtoi edhe Amendamentet 6,7 dhe 8 nga Qeveria (i përkrah apo nuk i përkrah) të cilat sugjerojnë përmirësime teknike.

5. Të ndryshme

Në pikën të ndryshme **Liburn Aliu** njoftoi komisionin për obligimin e marr nga Kryetari i Komisionit rreth raportit konfuz të djeshëm për kontaminimin e tokës bujqësore. Pasi që i njëjti kishte marr raportin në fjalë, komisioni vendosi të mbaj mbledhjen e radhës me ministrin e bujqësisë rreth raportit në fjalë, ndërsa stafi të përcjellë këtë raport anëtarëve të komisionit.

Projektligji për shërbime këshilluese në bujqësi e zhvillim rural përcjellët në leximin e dytë pasi që është shqyrtuar në komisionet e përhershme të Kuvendit.

Gjithashtu u vendos të shtyhen mbledhjet e nesërme dhe pasnesërme për javën tjetër për shkak të kushteve të rënda atmosferike.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,50.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani